



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT
I
AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio

R. nr. 611/2024

Në lidhje me mungesën e shërbimeve për rehabilitimin e vazhdueshëm shëndetësor, fizik dhe social për personat paraplegjik, tetraplegjik dhe personave me aftësi të kufizuar

Drejtuar:

Z. Arben Vitia, ministër në detyrë

Ministria e Shëndetësisë

Kopje: Z. Habit Hajredini – Drejtor

Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 17 qershor 2026

Qëllimi i raportit

Objekti i çështjes së këtij Raporti është mungesa e zbatimit të dispozitave të Ligjit nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë dhe Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi, përkitazi me rehabilitimin e vazhdueshëm shëndetësor, fizik dhe social për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë si dhe trajtimin, rehabilitimin psiko-social dhe risocializimin e personave me aftësi të kufizuara në bashkësi.

Raporti ofron gjetje dhe rekomandime konkrete lidhur me veprimet që duhet të ndërmerret Qeveria e Republikës së Kosovës në mënyrë që të evitohen shkeljet e drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit për shkak të mungesës së zbatimit të ligjeve që prekin të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe personave me aftësi të kufizuara.

Baza ligjore

Avokati i Popullit, në mes të tjerash, sipas Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- *Avokati i Popullit mund të jep rekomandime dhe të propozoj masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës publike dhe organeve tjera shtetërore; (neni 135, paragrafi 3 i Kushtetutës);*
- *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla; (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i Ligjit);*
- *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit; (neni 18 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 i Ligjit);*
- *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; (neni 18 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të Ligjit);*
- *të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 i Ligjit);*
- *të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës; (neni 18 paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 i Ligjit).*

1. Avokati i Popullit e dërgon këtë raport tek institucionet kompetente si dhe e publikon në ueb faqen zyrtare të institucionit.

Përshkrimi i rastit

2. Gjatë trajtimit të çështjeve që ndërlidhen me të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe të personave me aftësi të kufizuara, si dhe përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile që merren me mbrojtjen e të drejtave të

këtyre personave, Avokati i Popullit ka hasur dhe është vënë në dijeni për dispozita të ligjeve në fuqi të cilat nuk kanë gjetur zbatim në praktikë.

3. Ligji nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, i shpallur në Gazetën Zyrtare më 16 qershor 2016, në nenin 13 [Kujdesi shëndetësor], paragrafi 4, përcakton: *“Institucionet kompetente ofrojnë rehabilitim shëndetësor, fizik dhe social për përfituesit e këtij ligji, sipas vlerësimit të komisionit vlerësues”*.
4. Po ashtu, Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi, i shpallur në Gazetën Zyrtare më 7 maj 2013, në nenin 12 [Masat dhe veprimet], paragrafi 1.9, përcakton: *“Trajtimin, rehabilitimin psikosocial dhe risocializimin e personave me aftësi të kufizuara në bashkësi”*.
5. Sipas deklarimeve të vetë personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe të personave me aftësi të kufizuara, shërbimet e parashikuara me këto ligje do të kishin ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien, dinjitetin dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.
6. Me qëllim të sigurimit të informatave nga autoritetet përgjegjëse, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, më 2 shtator 2025, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) me kërkesë për informata lidhur me zbatimin e Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë në Kosovë, si dhe të Ligjit për Shëndetësi, përkatësisht lidhur me shërbimet që ofrohen nga institucionet shëndetësore për rehabilitimin e vazhdueshëm shëndetësor, fizik dhe social, si dhe për trajtimin, rehabilitimin psikosocial dhe risocializimin e personave me aftësi të kufizuara në bashkësi, ashtu siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse në fuqi.
7. Më 3 shtator 2025, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit pranoi përgjigje nga MSh, në të cilën thuhej se në kuadër të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) funksionon Klinika e Fiziatriisë me Rehabilitim Mjekësor, e cila ofron shërbime mjekësore edhe për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.
8. Më 27 janar 2026, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit u takua me përfaqësuesen e MSh-së, me ç’rast kërkoi informata më të detajuara lidhur me çështjen, pasi përgjigjja e datës 3 shtator 2025 nuk përmbushi pritshmëritë e Avokatit të Popullit në aspektin e ofrimit të informatave të plota. Me këtë rast, përfaqësuesja e MSh-së njoftoi se, përveç përgjigjes së dërguar më 3 shtator 2025, nuk dispononte informata të tjera lidhur me çështjen.
9. Më 21 maj 2026, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit u takua me përfaqësuesin e Shoqatës së Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës - HANDIKOS, i cili njoftoi se ligji nuk është duke u zbatuar dhe se nuk ekziston ndonjë akt nënligjor që rregullon çështjen e ofrimit të shërbimeve të rehabilitimit shëndetësor, fizik dhe social për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë në Kosovë. Gjithashtu, ai njoftoi se më 5 shkurt 2026, MSh ka emëruar grupin punues për hartimin dhe finalizimin e Udhëzimit Administrativ lidhur me kujdesin shëndetësor dhe institucionet kompetente që ofrojnë rehabilitim shëndetësor, fizik dhe social për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.
10. Në ndërkohë, përfaqësuesi i HANDIKOS-it konfirmoi se ligji vazhdon të mos zbatohet dhe njëkohësisht theksoi rëndësinë e finalizimit të këtij udhëzimi administrativ, i cili do të konkretizonte mënyrën e ofrimit të shërbimeve për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.
11. Sipas informatave që posedon Avokati i Popullit, ende nuk është hartuar apo finalizuar ndonjë draft i këtij akti nënligjor me qëllim të zbatimit të ligjit përkitazi me ofrimin e

shërbimeve për rehabilitimin e vazhdueshëm shëndetësor, fizik dhe social për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

12. Ndërkaq, Ligji nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, në nenin 13, paragrafi 5, përcakton se: *“Për zbatimin e këtij neni, Qeveria nxjerr akt nënligjor sipas propozimit të Ministrisë së Shëndetësisë.”*

Korniza ligjore e zbatueshme në Republikën e Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

13. Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] i Kushtetutës përcakton se të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.
14. Neni 24 [Barazia para ligjit] i Kushtetutës, përcakton se:
- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
 - 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
 - 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*
15. Neni 51 [Kujdesi shëndetësor dhe social] i Kushtetutës, përcakton se:
- 1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.*
 - 2. Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.*

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

16. Neni 14 [Ndalimi i diskriminimit]

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

17. Neni 1 [Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit], Protokollu 12 i KEDNJ

- 1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike apo çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësi në ndonjë minoritet kombëtar, lindja ose çdo situatë tjetër.*
- 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.*

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

18. Megjithëse, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas Kushtetutës nuk është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Republikën e Kosovës, ajo përmendet në vetë Ligjin nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë (neni 4)¹ dhe se padyshim shteti obligohet të zbatojë standardet e vendosura nga kjo Konventës për të Drejta të Personave me Aftësi të Kufizuara.
19. Konventa ndalon diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar (neni 5); garanton jetesën e pavarur dhe përfshirjen në komunitet (neni 19); garanton të drejtën e gëzimit të standardit më të lartë të mundshëm shëndetësor pa diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar (neni 25); dhe obligon shtetet të organizojnë dhe zgjerojnë shërbimet e rehabilitimit (neni 26).
20. Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 1 [Qëllimi]: *“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”*

Analiza dhe konstatimet e Avokatit të Popullit

21. Ligji nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë ka hyrë në fuqi që në vitin 2016. Megjithatë, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka arritur të nxjerrë aktin nënligjor për përcaktimin e shërbimeve të rehabilitimit shëndetësor, fizik dhe social për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, megjithëse kane kaluar 10 nga hyrja në fuqi e ligjit. Neni 13, paragrafi 5, i këtij ligji shprehimisht parasheh se për zbatimin e këtij neni, Qeveria duhet të nxjerrë akt nënligjor sipas propozimit të Ministrisë së Shëndetësisë.
22. Ky akt nënligjor do të duhej të konkretizonte llojet e shërbimeve rehabilituese; mënyrën e organizimit dhe ofrimit të tyre; standardet profesionale dhe institucionale; kriteret e përfitimit; përgjegjësitë institucionale dhe financimin e shërbimeve
23. Po ashtu, Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi, në nenin 12 paragrafi 1.9, e përcakton si masë dhe veprim të sistemit shëndetësor trajtimin, rehabilitimin psikosocial dhe risocializimin e personave me aftësi të kufizuara në bashkësi. Kjo dispozitë vendos një obligim pozitiv për shtetin që të organizojë dhe ofrojë shërbime të përshtatshme rehabilituese dhe sociale për këtë grup të qytetarëve.
24. Në rastin konkret, te dy këto ligje ua njohin personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe personave me aftësi të kufizuar të drejtën në rehabilitim vazhdueshëm shëndetësor, fizik dhe social, si dhe për trajtimin, rehabilitimin psikosocial dhe risocializimin e personave

¹ Neni 4 - Mbrojtja “Përfituesit e këtij ligji mbrohen nga të gjitha llojet dhe format e diskriminimit, shfrytëzimit, abuzimit, fyerjes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të njohura nga Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut e me theks të veçantë me standardet dhe parimet e përcaktuara me Konventën Ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.”

me aftësi të kufizuara në bashkësi. Por, mungesa e zbatimit praktik të këtyre ligjeve bën që ata të mos përfitojnë të drejtat në mënyrë efektive.

25. Mos nxjerrja e aktit nënligjor dhe mungesa e shërbimeve të parapara me ligj tregojnë se shteti nuk ka ndërmarrë masa të mjaftueshme për realizimin efektiv të obligimeve kushtetuese për barazinë para ligjit, kujdesin shëndetësor dhe social dhe respektimin e instrumenteve dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
26. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, praktika e së cilës në Republikën e Kosovës shërben për të interpretuar të drejtat e njeriut (neni 53 i Kushtetutës), ka theksuar vazhdimisht se personat me aftësi të kufizuar përbëjnë një grup veçanërisht të cenueshëm dhe kërkojnë mbrojtje të shtuar nga autoritetet publike.
27. Gjykata ka trajtuar çështje në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara sipas neneve të ndryshme të Konventës. Gjykata ka identifikuar personat me aftësi të kufizuara si të një grupi veçanërisht të cenueshëm, duke vënë në dukje se ata historikisht i janë nënshtruar diskriminimit dhe paragjykitimit që ka rezultuar në përjashtimin e tyre social. Një paragjykim i tillë mund të sjellë stereotipe legjislative që ndalojnë vlerësimin e individualizuar të kapaciteteve dhe nevojave të tyre. Prandaj, Gjykata ka theksuar nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri, duke nënvizuar se liria e vlerësimin të shtetit është në thelb më e ngushtë në këtë kontekst dhe se ai duhet të ketë arsye shumë të rëndësishme për kufizimin e të drejtave themelore të këtyre njerëzve. (*Glor k. Zvicrës*, 2009, § 84; *Guberina k. Kroacisë*, 2016, § 73).²
28. Çfarë është e vërtetë, për dallim nga rastet më sipër, të trajtuara nga GjEDNJ, në rastin konkret në Republikën e Kosovës janë në fuqi ligjet që personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe personave me aftësi të kufizuar u njohin të drejtën në rehabilitim vazhdueshëm shëndetësor, fizik dhe social, si dhe për trajtimin, rehabilitimin psikosocial dhe risocializimin e personave me aftësi të kufizuara në bashkësi. Mirëpo, GjEDNJ, në rastin *Savez crkava „Riječ života“ dhe të tjerët kundër Kroacisë*, theksoi se fusha e veprimtimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 12 të KEDNJ është më e gjerë se ajo e Nenit 14 të Konventës, pasi ai ndalon diskriminimin në gëzimin e çdo të drejte të parashikuar me ligj. Gjykata sqaroi se kjo dispozitë zbatohet jo vetëm kur diskriminimi lidhet me të drejtat e garantuara nga KEDNJ, por edhe kur ai lidhet me të drejta, përfitime ose mundësi që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar ose nga veprimet e autoriteteve publike. Në këtë kuptim, shteti ka detyrimin që të sigurojë që të drejtat e njohura nga ligji të jenë të qasshme dhe të gëzohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë, pa dallime të pajustificuara.
29. Në dritën e këtij standardi, ekzistenca e dy ligjeve në fuqi, të cilat njohin dhe garantojnë të drejta të caktuara por që nuk zbatohen në praktikë, ngre çështje serioze nga perspektiva e Nenit 1 të Protokollit Nr. 12. GjEDNJ ka theksuar vazhdimisht se të drejtat duhet të jenë praktike dhe efektive, e jo teorike dhe iluzore. Prandaj, kur individëve ose një kategorie personash u mohohet në praktikë përfitimi nga të drejtat e garantuara me ligj për shkak të moszbatimit të tyre nga autoritetet publike, kjo mund të përbëjë trajtim diskriminues,

² https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/Guide_Social_Rights_ALB

veçanërisht nëse personat e prekur vendosen në një pozitë të pafavorshme krahasuar me të tjerët që mund t'i gëzojnë ato të drejta në mënyrë efektive.

30. Mosveprimi i autoriteteve ka bërë që personat paraplegjikë, tetraplegjikë dhe personat me aftësi të kufizuara të mos kenë qasje efektive në shërbimet që ligji ua garanton. Kjo situatë cenon të drejtën për shëndet, dinjitetin njerëzor, përfshirjen sociale dhe barazinë para ligjit, ndërsa njëkohësisht përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, në kundërshtim me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit, duke u bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore*”. Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit “*(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...)*”, si dhe “*të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.*” (neni 18, paragrafi 1.7).

Prandaj, Avokati i Popullit,

REKOMANDON

Ministrisë së Shëndetësisë që:

1. *Të hartoi aktin nënligjor të paraparë me nenin 13, paragrafi 5 të Ligjit nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë;*
2. *Gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave dhe akteve nënligjore, të sigurohet përfshirja e organizatave përfaqësuese të personave paraplegjikë, tetraplegjikë dhe personave me aftësi të kufizuara;*
3. *Të hartohen procedura dhe standarde të qarta për qasjen në shërbimet e rehabilitimit, në përputhje me nevojat e personave paraplegjikë, tetraplegjikë dhe personave me aftësi të kufizuara;*
4. *Të ndërmerret masa për krijimin dhe funksionalizimin e shërbimeve të rehabilitimit shëndetësor, fizik dhe social për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë në të gjithë territorin e Kosovës;*
5. *Të sigurohet zbatimi i plotë i nenit 12, paragrafi 1.9 të Ligjit për Shëndetësi, përmes programeve të trajtimit, rehabilitimit psikosocial dhe risocializimit në komunitet për personat me aftësi të kufizuara;*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“ Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Nr. 05/L-019 (“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen

brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutem të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit

